

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës

Analizë për periudhën
janar-qershor



Tetor 2020

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës

Tetor 2020

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Ndryshimet në Bruto Produktin Vendor (BPV)	4
2.1 BPV sipas qasjes së shpenzimeve me çmime konstante	4
2.2 BPV sipas qasjes së të ardhurave	6
3. Ndryshimet në sektorin financiar	9
3.1 Bankat komerciale	9
3.3 Fondi pensional dhe kompanitë e sigurimeve	12
4. Sektori i jashtëm (remitencat dhe investimet e huaja direkte)	14
5. Ndryshimet në import dhe eksport të mallrave dhe shërbimeve	15
Importi dhe eksporti i mallrave	15
Bilanci i pagesave të shërbimeve	16
6. Ndryshimet e çmimeve	17
7. Ndryshimet në buxhetin e shtetit	18
7.1 Ndryshimet në të hyrat buxhetore në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2020	18
7.2 Ndryshimet në shpenzime buxhetore për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2020	19
7.3 Masat stabilizuese të ekonomisë nga Qeveria e Kosovës	21
8. Përfundime	23
9. Aneksi	24

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur

Originali është shkruar në shqip

Ky publikim është mbështetur nga:

Përmbledhje ekzekutive

Pas shfaqjes së pandemisë COVID-19 në Kosovë, Qeveria kufizoi lëvizjen e qytetarëve dhe urdhëroi mbylljen e pjesës dërmuese të ekonomisë për më shumë se dy muaj. Masat parandaluese të përhapjes së pandemisë shkaktuan rënien më të lartë të prodhimit vendor që nga paslufta duke bërë Bruto Produktin Vendor (BPV) të bie për 9.28 përqind në tremujorin e dytë. Instituti GAP në këtë raport paraqet ecurinë e komponentëve kryesor që përbëjnë BPV-në dhe indikatorët tjerë makroekonomik në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 (janar-qershor) me qëllim që të pasqyrojë ndikimin e kësaj krize në gjithë sektorët ekonomik të vendit. Të gjeturat kryesore të këtij raporti janë:

- Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti shpenzimet e brendshme pësuan ndryshime të mëdha. Konsumi shtëpiak u orientua kryesisht në produkte bazike, si ushqimi dhe shërbimet publike (ujë dhe energji elektrike), ndërkaq bizneset shpenzuan më shumë në digjitalizimin e shërbimeve për të operuar gjatë pandemisë.
- Aktivitetet ekonomike që performuan më së miri janë: industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike dhe furnizimi me ujë të cilat në tremujorin e dytë u rritën për 19.8 përqind dhe informacioni dhe komunikimi për 29.6 përqind.
- Ndërkohë, rënie të të hyrave patën të gjitha industritë e tjera. Ndër më të lartat ishin në industrinë e ndërtimit me -47.08 përqind, dhe tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor -24.4 përqind.
- Gjatë gjathtëmujorit të parë të këtij viti industritë deklaruan rreth 584 milionë euro ose 11 përqind më pak qarkullim në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.
- Në anën tjetër për të lehtësuar barrën financiare, pas fillimit të masave kufizuese, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) bashkë me institucionet kredituese ofruan mundësinë e shtyrjes së afatit të pagesave të kësteve të kredisë për tre muaj, e më pas mundësinë e aplikimit për ristrukturim të tyre.
- Qeveria e Kosovës aprovoi pakon e parë “emergjente fiskale” me vlerë prej 190 milionë euro dhe propozoi riorientimin e disa shpenzime buxhetore nga kategoria e shpenzimeve kapitale në kategorinë e pagave, transfereve dhe subvencioneve. Megjithatë, kjo pako nuk arriti të implementohej në tërësi në tremujorin dytë dhe si rezultat shumë qytetarë dhe biznese nuk morën ndihmën në kohën e duhur.
- Shpenzimet publike më 2020 u rritën për 18.8 milionë euro ose rreth 2 përqind, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2019. Ndërkaq të hyrat buxhetore shënuan rënie në gjitha kategoritë. Reduktimi i të hyrave buxhetore ndërlidhet me performancën e dobët të sektorit privat dhe rënien e kërkesës agregate.
- Kjo periudhë kohore u shoqërua me rënie të kredive të reja dhe ngritje të depozitave bankare, ku depozitat arritën vlerën rekorde prej afër 4 miliardë euro. Këto dy dukuri pasqyrojnë rënien e kërkesës së përgjithshme në gjashtëmujorin e parë.
- Aspektet tjera që zvogëluan ekonominë gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti ishin rënia e eksporteve të shërbimeve, veçanërisht atyre të transportit, që ndërlidhet me kufizimin e qarkullimit ndërkufitar dhe mos-ardhjes së diasporës.

1. Hyrje

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë zyrtarisht shpalli sëmundjen COVID-19 pandemi globale. Si përgjigje ndaj kësaj krize shëndetësore, e cila po shpërndahej me shpejtësi në të gjitha vendet e botës, liderët shtetërorë urdhëruan izolimin e qytetarëve dhe mbylljen e pothuajse gjithë aktivitetit ekonomik.

Në këtë situatë u përfshi edhe Kosova, ku pas konfirmimit të dy rasteve të para me këtë virus, qeveria mori vendim për mbylljen e të gjitha aktiviteteve ekonomike, kulturore e sportive, me përjashtim të disa veprimtarive esenciale si furnizimi me produkte ushqimore dhe mjekësore nga data 13 mars deri më 18 maj 2020.¹ Me këtë vendim u ndalua edhe qarkullimi i transportit ndër-urban dhe ndërkombëtar, ndërsa tri ditë më vonë edhe udhëtimi ajror.

Pas pezullimit të pothuajse të gjithë aktivitetit ekonomik global, bota padyshim po lëviz drejt një recesioni të thellë. Mirëpo, për dallim nga krizat ekonomike paraprake, ku zgjidhja e problemit ishte më e lehtë, kjo situatë është e paparashikueshme dhe e paprecedent. Kosova, për herë të parë që nga paslufta, pritet të përballlet me një krizë ekonomike shkalla e së cilës ende nuk dihet. Sipas Bankës Botërore, Kosova bën pjesë në vendet ku prodhimtaria në vitin 2020 pritet të bie për 8.8 përqind.² Megjithatë, ecuria e ngadalësimit ekonomik do të varet nga disa faktorë, si: aftësia e kontrollimit të shpërndarjes së virusit, efikasiteti i masave ekonomike të ndërmara nga qeveria për të lehtësuar rimëkëmbjen ekonomike, dhe pritshmëritë e konsumatorëve dhe bizneseve për të ardhmen e ekonomisë së vendit.

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të ndikimit të pandemisë në ekonomi është Bruto Produkti Vendor (BPV) i cili përmbledh tërë prodhimin e një shteti brenda një periudhe të caktuar.

2. Ndryshimet në Bruto Produktin Vendor (BPV)

BPV është një ndër treguesit më gjithpërfshirës të ecurisë së ekonomisë brenda një periudhe kohore. Ekzistojnë dy metoda të matjes së BPV-së të cilat shpjen në rezultatin e njëjtë mirëpo paraqesin këndvështrime të ndryshme. Për shembull, meqë çdo shpenzim i një individi është e ardhur për dikë tjetër, ashtu edhe shuma totale e shpenzuar është e barabartë me të ardhurat totale. Në këtë mënyrë llogaritet edhe BPV, ku një metodë paraqet shpenzimet totale, ndërsa tjetra të ardhurat e gjithë ekonomisë.

Për të paraqitur ndikimin e pandemisë në ekonomi, fillimisht do të shohim cilat shpenzime janë reduktuar (kapitulli 2.1) e më pas të ardhurat e cilës industri janë prekur si pasojë e reduktimit të shpenzimeve (kapitulli 2.2).

2.1 BPV sipas qasjes së shpenzimeve me çmime konstante


Në shtatë vitet e fundit, mesatarja e rritjes së BPV në tremujorin e parë (janar-mars) ishte 3.82 përqind ndërsa në tremujorin e dytë (prill-qershor) 3.71 përqind. Pas 13 mars 2020, kur aktiviteti ekonomik pothuajse i tëri u mbyll, ndikimi në ekonomi ishte i menjëhershëm duke bërë tremujorin e parë të rritet për vetëm 1.31 përqind apo 2.51 pikë përqindje më pak se mesatarja e viteve të fundit. Në

¹ Vendim. Qeveria e Republikës së Kosovës. Nr. 01/09. <https://bit.ly/2S8UxsH>

² Banka Botërore. Burimi: <https://bit.ly/3ji95RC>

anën tjetër, meqë koha e mbylljes së ekonomisë dhe rihapja graduale më së shumti i përkasin tremujorit të dytë, të dhënat e BPV-së tregojnë se prodhimi i brendshëm shënoi rënien më të madhe që nga paslufta me 9.28 përqind.³

Figura 1. Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës

Faktorët që ndikuan në rënien e BPV-së në tremujorin e dytë ishin formimi i kapitalit bruto me -41.09 përqind dhe eksporti i shërbimeve me -62.93 përqind.⁴ Formimi i kapitalit bruto në aspektin biznesor përfshin akumulimin e inventarit biznesor dhe investimet në kapacitete prodhuese ndërsa në aspektin familjar nënkupton blerjen e një shtëpie të re e cila në BPV llogaritet si investim dhe jo konsum. Rënia e këtij indikator për dy tremujorë rresht tregon për pritshmëritë e ulëta të bizneseve dhe ekonomive familjare për të ardhmen e ekonomisë.


Ndërkohë, në tremujorin e dytë pati rritje të konsumit familjar për 3.47 përqind, eksporti i mallrave për 12.18 përqind dhe shpenzimeve të qeverisë për 8.58 përqind.⁵

3 Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor TM2 2020. Burimi: <https://bit.ly/3jlhyEr>

4 Ibid.

5 Ibid.

Figura 2. Bruto Produkti Vendor sipas metodës së shpenzimeve me çmime konstante (në miliardë)



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës


2.2 BPV sipas qasjes së të ardhurave

Të hyrat e aktiviteteve ekonomike që u prekën më së shumti nga rënia e shpenzimit në tremujorin e dytë ishin ndërtimi me -47.08 përqind, tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor -24.4 përqind, aktivitetet profesionale dhe administrative -16.39 përqind, aktivitetet financiare dhe të sigurimit -6.71 përqind dhe bujqësia, pyjet dhe peshkimi -1.74 përqind. Ndërkaq, rritje reale shënuan aktivitetet si: industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, dhe furnizimi me ujë 19.8 përqind, informacioni dhe komunikacioni 29.6 si dhe administrimi publik, arsimi dhe shëndetësia 4.73 përqind.⁶

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), gjatë gjatshtëmujorit të parë të këtij viti u deklaruan rreth 584 milionë euro ose 11 përqind më pak të hyra se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga kjo shumë, më së shumti ndikim pati rënia e qarkullimit të aktiviteteve të tregtisë dhe riparimit të mjeteve motorike (-241.5 milionë), ndërtimtaria (-77.2 milionë), transporti dhe magazinimi (-72 milionë), industria përpunuese (-54.2 milionë) dhe të tjera të paraqitura si përqindje në figurën 3. Rënia e qarkullimit të bizneseve ka ndikuar edhe në të hyrat tatimore të cilat janë paraqitur në kapitullin 7.1.

6 Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor (BPV) TM2 2020. Burimi: <https://bit.ly/3cLWSTC>

Figura 3. Ndryshimi i deklarimit të qarkullimit në Administratën Tatimore për gjashtëmujorët 2019-2020



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës⁷

Performanca e dobët e industrive në gjashtëmujorin e parë ndërlidhet më së shumti me mbylljen e ekonomisë për më shumë se dy muaj, e më pas hapja graduale e disa industrive deri në muajin qershor. Hapja e bizneseve në mënyrë jo të sinkronizuar paraqet pengesë në realizimin e të hyrave optimale marrë parasysh zinxhirin e furnizimit ku prodhimi i një industrie mund të jetë lëndë e parë për industrinë tjetër.

Në këtë situatë ekonomike, disa industri do të pësojnë më shumë se sa të tjerat. Kjo për faktin se qarkullimi i industrive në Kosovë realizohet në formë ciklike ku secila industri në periudha të ndryshme të vitit realizon të hyrat më të larta. Industritë që normalisht realizojnë pikun e të hyrave gjatë tremujorit të dytë, këtë vit do ta kenë më të vështirë rikuperimin e humbjeve sepse periudha më e rëndësishme e vitit i gjeti pothuajse tërësisht të mbyllura. Në këtë kategori bëjnë pjesë industria e ndërtimit, patundshmërisë, arteve, argëtimit dhe rekreacionit, të paraqitura në tabelën 1. Gjatë muajve prill-qershor 2020, industria e ndërtimit deklaroi 37 përqind më pak të hyra, aktivitetet e patundshmërisë -40 përqind, ndërsa industria e arteve, argëtimit dhe rekreacionit -85 përqind më pak se në kohën e njëjtë të vitit të kaluar.⁸ Këto janë të hyra të humbura që nuk mund të rikuperohen lehtë brenda vitit sepse piku i këtyre industrive ka kaluar. Prandaj vonesat në implementimin e masave mbështetëse nga qeveria dhe Banka Qendrore mund të rrezikojnë edhe të hyrat e industrive të tjera gjatë muajve të ardhshëm të vitit.

⁷ Administrata Tatimore e Kosovës të dhënat e dërguara me email.

⁸ Ibid.

Tabela 1. Të hyrat e sektorëve sipas tremujorëve të vitit 2019 (në euro)

Sektori	Të hyrat		TM1	TM2	TM3	TM4
	▲ më të larta	▼ më të ulëta				
Bujqësia, pylltaria, peshkimi	TM4	TM1	▼ 91,426,000	136,429,000	106,388,000	▲ 144,194,000
Industria nxjerrëse	TM3	TM4	39,552,000	41,023,000	▲ 45,729,000	▼ 27,747,000
Industria përpunuese	TM3	TM1	▼ 123,194,000	220,655,000	▲ 235,261,000	227,156,000
Furnizimi me energji elektrike dhe gaz	TM1	TM3	▲ 66,033,000	55,397,000	▼ 55,062,000	56,472,000
Furnizimi me ujë	TM2	TM4	11,859,000	▲ 13,686,000	12,240,000	▼ 11,740,000
Ndërtimtaria	TM2	TM1	▼ 100,284,000	▲ 195,716,000	173,482,000	147,976,000
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	TM3	TM1	▼ 159,725,000	208,501,000	▲ 295,495,000	263,736,000
Transporti dhe magazinimi	TM3	TM1	▼ 44,805,000	76,398,000	▲ 91,122,000	58,878,000
Hotelet dhe restorantet	TM3	TM1	▼ 18,696,000	21,082,000	▲ 27,450,000	21,847,000
Informimi dhe komunikimi	TM4	TM1	▼ 24,272,000	24,962,000	38,159,000	▲ 39,293,000
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	TM3	TM1	▼ 60,799,000	70,057,000	▲ 72,311,000	63,625,000
Afarizmi me pasuri të patundshme	TM2	TM1	▼ 121,520,000	▲ 130,287,000	127,845,000	127,779,000
Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	TM4	TM2	30,448,000	▼ 19,665,000	21,278,000	▲ 30,718,000
Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	TM3	TM1	▼ 7,204,000	12,861,000	▲ 15,348,000	14,815,000
Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	TM4	TM1	▼ 118,833,000	128,587,000	128,879,000	▲ 150,635,000
Edukimi	TM2	TM3	64,684,000	▲ 66,490,000	▼ 60,188,000	66,476,000
Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	TM4	TM1	▼ 28,827,000	32,420,000	32,703,000	▲ 34,508,000
Art, zbavitje dhe rekreacion	TM2	TM4	6,991,000	▲ 7,471,000	4,564,000	▼ 3,199,000
Shërbime tjera	TM3	TM1	▼ 2,767,000	3,721,000	▲ 4,043,000	3,365,000
Taksta neto ne produkte	TM3	TM1	▼ 282,501,000	324,884,000	▲ 404,098,000	366,176,000
Gjithsej BPV	TM3	TM1	▼ 1,404,421,000	1,790,290,000	▲ 1,951,644,000	1,860,334,000

3. Ndryshimet në sektorin financiar

Kosova, nga viti 2002 në mënyrë të njëanshme ka adaptuar euron si valutë zyrtare. Me këtë akt është kufizuar mundësia e intervenimit në ekonomi përmes politikave monetare. Rrjedhimisht, ndikimin kryesor në injektimin e parasë në ekonomi e kanë institucionet kredituese si bankat komerciale dhe institucionet tjera financiare të cilat stimulojnë konsumin shtëpiak, shtetëror, dhe investimet e bizneseve.


3.1 Bankat komerciale

Pas ndaljes së aktivitetit ekonomik për më shumë se dy muaj, të hyrat e bizneseve u ndalën, ndërkaq obligimet ndaj institucioneve kredituese mbetën. Për të tejkaluar sa më lehtë vështirësitë me të cilat ballafaqoheshin disa biznese dhe për të evituar rritjen e kredive të dështuara, BQK në bashkëpunim me institucionet kredituese fillimisht ofruan mundësinë e shtyrjes së afatit të pagesave të kësteve të kredisë për tre muaj, nga data 16 mars deri më 16 qershor 2020, e më pas mundësinë e aplikimit për ristrukturim të tyre.⁹ Vetëm në muajin mars, 44,670 kërkesa u dorëzuan për shtyrje të pagesës së kredisë. Vlera e tyre ishte 1.3 miliardë euro, ku 71.5 përqind ishin nga bizneset.¹⁰ Ndërsa për ristrukturim të kredive deri në muajin korrik u aprovuan mbi 70,500 kërkesa ku 80 përqind ishin për persona fizik ndërsa 20 përqind për biznese.¹¹

Këto dy masa lehtësuan barrën financiare të disa bizneseve dhe qytetarëve, mirëpo krijuan stres të likuiditetit te bankat komerciale pasi që të hyrat bankare nga këto kredi u shtyen, ndërsa depozitat e klientëve të tjerë mbetën aktive.¹² Falë gjendjes mjaft likuide të bankave komerciale, këto masa u mundësuan pa rrezikuar stabilitetin financiar.

Përveç aplikimeve për shtyrje apo ristrukturim të kredive, të dhënat e sistemit bankar në gjashtëmujorin e parë tregojnë se ka ngritje të depozitave dhe rënie të kredive të reja. Këto dy dukuri reduktojnë qarkullimin e parasë në ekonomi duke shkaktuar rënie të kërkesës agregate. Në tremujorin e dytë, shumica e kredive të reja ishte 48 përqind më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.¹³ Kreditimi u reduktua në të gjithë sektorët me përjashtim të atij bujqësor që pati një rritje të lehtë prej dy përqind krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019.

Figura 4. Kreditë e reja nga bankat komerciale në Kosovë të gjashtëmujorëve të parë 2018-2020 (në miliona euro)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

9 Banka Qendrore e Kosovës. Burimi: (1) <https://bit.ly/2Tkvjvpj>, (2) <https://bit.ly/326FGEv>

10 Deklaratë e zëdhënësit të Bankës Qendrore dhënë portalit 'Evropa e Lirë'. Burimi: <https://bit.ly/2WVW05K>

11 Banka Qendrore e Kosovës. Bankat Komerciale. Burimi: <https://bit.ly/3cMWjYP>


12 Banka Qendrore e Kosovës. Bankat Komerciale. Burimi: <https://bit.ly/3cMWjYP>

13 Banka Qendrore e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/2WshdGF>

Vazhdimi i kredidhënies në këto rrethana është i domosdoshëm në mënyrë që të mundësohet stimulimi i konsumit të ekonomive familjare dhe investimet në sektorin privat. Megjithatë, në muajt në vijim kur pritet që gjendja e sektorit privat të vështirësohet edhe më tutje, fakti se bankat komerciale janë likuide dhe me kapital të lartë mund të jetë i pamjaftueshëm për të vazhduar kreditimi. Bankat mund të vlerësojnë se ekziston një ambient i rrezikshëm për ofrim të kredive të reja dhe si rezultat të reduktojnë kreditë e reja edhe më shumë. Në këtë situatë, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) mund të luajë një rol kyç në marrjen përsipër të një pjese të rrezikut dhe të mundësojë vazhdimin e kredidhënies. Fonde të ngjajshme u treguan efektive në shumë vende të botës gjatë krizës globale financiare.

Në tremujorin e dytë të këtij viti, numri dhe shuma e kredive të garantuara nga FKGK pësoi rënie të konsiderueshme. Falë grantit të KfW-së, këtë vit FKGK do të ketë edhe 6.5 milionë euro më shumë për të zgjeruar kapitalin e saj garantues.¹⁴ Mirëpo, për të përballuar kërkesën e bizneseve për kredi të reja gjatë thellimit të krizës ekonomike, kërkohet rritje edhe më e lartë e këtij fondi. Mbashtetja e FKGK-së është propozuar në pakon e dytë përmes Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike.¹⁵

Figura 5. Shuma e kredive të reja dhe të garantuara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore



Burimi: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

¹⁴ Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Burimi: <https://bit.ly/2AMfK61>


¹⁵ Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike. Kuvendi i Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/2FG3YN6>

3.2 Institucionet mikrofinanciare

Kreditë e reja pësuan rënie edhe në institucionet mikrofinanciare. Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, kreditimi u reduktua për 59 përqind.¹⁶ Kjo tkurrje e portfolios së kredisë është e pritshme për arsye të këto institucione nuk pranojnë depozita nga klientët dhe si rrjedhojë kanë ekspozim më të lartë ndaj rrezikut të likuiditetit në rast të rritjes së kredisë të dështuara. Rënia e kredisë të reja mund të ndërlidhet edhe me rënien e kërkesës për kredi.

Institucionet mikrofinanciare kryesisht ofrojnë kredi jo më shumë se 25 mijë euro për familje dhe individë me të ardhura të ulëta apo për mikro-subjekte. Mungesa e kredisë nga këto institucione ndikon më së shumti tek qytetarët dhe mikro-bizneset me të ardhura të ulëta dhe kolateral të pamjaftueshëm për të aplikuar në banka komerciale. Edhe në këtë situatë, zgjerimi i portfolios së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore mund të jetë i rëndësishëm në garantimin e një pjese të kredisë së këtij grupi në mënyrë që t'u mundësohet kreditimi nga bankat komerciale, ku norma e interesit është më e përballueshme. Mungesa e qasjes në financa është një tjetër arsye se si kjo krizë pritet të jetë e vështirë për individë me të ardhura të ulëta. Reduktimi i domosdoshëm i shpenzimeve të këtij grupi, thëllon rënien e BPV-së. Prandaj qasja në financa nëse nuk bëhet përmes kredisë dhe punësimit rrezikon të bëhet përmes asistencës sociale si pasojë e thëllimit të varfërisë.

Figura 6. Kreditë e reja nga institucionet mikrofinanciare në Kosovë (në miliona euro)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës¹⁷

¹⁶ Banka Qendrore e Kosovës. Institucionet mikrofinanciare. Burimi: <https://bit.ly/3cMmQ8r>

¹⁷ Ibid.

3.3 Fondi pensional dhe kompanitë e sigurimeve

Për dallim nga bankat komerciale ku depozitat e klientëve mund të tërhiqen në çdo moment, fondet pensionale kanë pagesa më të parashikueshme. Për këtë arsye lejohen të investojnë edhe në tregje financiare ndërkombëtare për aq kohë sa në terma afatgjatë kursimet pensionale performojnë mbi normën mesatare të inflacionit të Kosovës.¹⁸ Kjo liri investive përmban edhe rrezikun e humbjeve të fondeve gjatë lëkundjeve të çmimeve në tregjet financiare.

Sipas Ligjit të fondit pensional, fondi nuk është mjet për arritjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Fondi ka për qëllim vetëm maksimizimin e kthimit të kontributdhënësve të saj. Në këtë drejtim synohet që gjatë investimit, qëllim të jetë siguria e fondeve pensionale, diversifikimi i investimeve për të reduktuar rrezikun dhe mbajtja e likuiditetit të mjaftueshëm për të kryer pagesat për ata që i plotësojnë kriteret për të përfituar nga fondi pensional.

Ekzistojnë dy fonde pensionale në Kosovë, Trusti pensional me shumicën dërmuese të tregut dhe fondi privat “Sloveno Kosovar”. Sa i përket Trustit, fondet e kursimeve pensionale investohen përmes kompanive menaxhuese të specializuara në investime financiare, të cilat raportojnë rregullisht në komisionin investiv të Trustit. Fillimisht, Bordi Drejtues i fondit aprovon Deklaratën e Parimeve të Investimeve (DPI) dhe përmes strategjisë së investimeve përcaktohen kufijtë dhe synimet e kategorive investive.¹⁹ Në këtë strategji asetë më likuid dhe i sigurtë është keshi ku përfshihen bonot e thesarit të Kosovës, depozitat bankare dhe të hollat në tranzit. Asetet tjera janë obligacionet e Kosovës me maturitet mbi një vjet dhe instrumente të tjera të paraqitura në tabelën 2 të rënditura në bazë të rrezikshmërisë së asetit.²⁰

Tabela 2. Caqet e investimit dhe alokimit të tyre në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019-2020

Klasa e asetit	Caku	Investimi në qershor 2019	Investimi në qershor 2020
Kesh	35%	34.6%	33.1%
Obligacione të Kosovës	15%	12.2%	19.5%
Instrumente borxhi	5%	5.0%	1.6%
Multi-asete	30%	35.9%	33.6%
Aksione	15%	12.4%	12.2%
Fondi total i investuar		1,863,348,229€	2,005,492,497€

Burimi: Trusti Pensional i Kosovës²¹

Kriza e pandemisë në fund të muajit shkurt ka shkaktuar një lëkundje të rëndë në tregjet financiare globale. Komisioni investues në fillim të këtyre lëkundjeve ka tërhequr investimet nga kategoria e aksioneve dhe i ka kthyer ato në Kosovë ku rrezikshmëria është më e ulët. Si rezultat, në muajin shkurt ekspozimi në tregjet e aksionit ishte në nivelin më të ulët historik të Trustit me 3.8 përqind, keshi u rrit në 34.4 përqind. Në muajin mars janë rikthyer investimet në aksione me shpresë që pas rënies së tregjeve financiare, çmimet e aksioneve janë nën vlerën reale të

¹⁸ Manuali i Investimeve. Trusti. Burimi: <https://bit.ly/3kcXxAe>


¹⁹ Ibid.

²⁰ Trusti pensional i Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/2Ti3Maj>

²¹ Ibid.

tregut. Megjithatë, në figuren 7 shohim se gjatë muajit shkurt dhe mars, Trusti ka pësuar humbje në interes me vlerë afër 100 milionë euro. Kjo rënie u shkaktua kryesisht nga rënia e çmimeve të aksioneve.²² Lëkundjet e tregjeve financiare vazhduan edhe gjatë tremujorit të dytë mirëpo në këtë periudhë është realizuar fitim në interes dhe si rrjedhojë kishte ngritje të lehtë të çmimit të njësisë së Trustit.²³

Figura 7. Ndryshimet në interes dhe çmim të njësisë së Trustit në gjashtëmujorin e parë 2020



Burimi: Trusti Pensional i Kosovës

Rënia e vlerës së aseteve të Trustit pensional nuk paraqet ndonjë ndikim në kërkesën agregate afatshkurte të ekonomisë e rrjedhimisht as në BPV. Fondi pensional, nga viti 2020, ka filluar me dy portfolio investuese njëra për personat nën moshën 65 vjeçare dhe tjetra për persona mbi 65 vjeç që është më konservativ në investime. Kjo do të thotë që kursimet e personave që marrin pensionin nga Trusti nuk janë të investuara në asete që kanë lëkundje apo rrezikshmëri të lartë. Prandaj rënia e çmimit të njësisë ose humbjet eventuale afatshkurte nuk kanë ndikim të madh në të ardhurat e personave që tashmë përfitojnë nga Trusti.

Në muajt në vijim, rëndësia e fondit pensional mund të jetë thelbësore në ofrimin e likuiditetit në sektorin financiar. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të investimit jashtë vendit, në fund të tremujorit të parë dhe gjatë tremujorit të dytë, kursimet pensionale në masë të madhe janë investuar në obligacionet e Qeverisë së Kosovës (392 milionë) si dhe në depozita bankare.²⁴ Kjo mundëson rritjen e borxhit publik të brendshëm pa shterrur fondet e gatshme për kreditë e sektorit privat.

Sektori i kompanive të sigurimit ka pjesëmarrje më të ulët në sektorin e përgjithshëm financiar me afër 2.7 përqind të aseteve të përgjithshme. Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, asetet e kompanive të sigurimit shënuan një rritje të ngadalësuar krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Derisa në vitin e kaluar asetet e gjashtëmujorit të parë u ngritën për rreth tetë përqind, këtë vit pati një rritje prej gjashtë përqind.²⁵ Në këtë rritje të aseteve bëjnë pjesë rritja

²² Raportimi tremujor. Lista e aseteve pensionale. Burimi: <https://bit.ly/3cAFksF>

²³ Trusti pensional i Kosovës. Raportet financiare. Burimi: <https://bit.ly/36eoWIM>

²⁴ Trusti pensional i Kosovës. Alokimi Strategjik. Burimi: <https://bit.ly/2SoCrIR>

²⁵ Banka Qendrore e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3g6QFCC>


e blerjes së letrave me vlerë, rritja e depozitave në bankat komerciale e të tjerë. Kapitalizimi i sektorit të sigurimeve është i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit të sektorit financiar dhe në mbulimin e pagesave dhe detyrimeve ndaj klientëve.

4. Sektori i jashtëm (remitencat dhe investimet e huaja direkte)

Remitencat, përveç që kanë karakter zhvillimor në stimulimin e kërkesës në ekonomi dhe qarkullimit të parasë, kanë edhe aspektin pozitiv social. Në vitin 2012, më shumë se 22 përqind e familjeve kosovare deklaruan se pranojnë remitenca nga familjarët e tyre.²⁶ Në vitin 2019, mbi 850 milionë euro u dërguan nga jashtë apo rreth 12.2 përqind e Bruto Produktit Vendor.²⁷ Në gjatëmujorin e parë të këtij viti, mbi 433 milionë euro janë dërguar nga jashtë në forma të ndryshme. Krahasuar me gjatëmujorin e parë të vitit 2019, këtë vit remitencat shënuan një rritje për mbi 27.5 milionë euro apo rreth 7 përqind.²⁸ Kjo mund të ketë ndikuar në rritjen e konsumit final të ekonomive shtëpiake që në tremujorin e dytë pati një ngritje prej 3.47 përqind. Megjithatë, kufizimet e lëvizjes përmes kufirit tokësor dhe ajror pamundësuan ardhjen e diasporës të cilët stimulojnë ekonominë gjatë gjithë vitit e veçanërisht në muajt e verës kur realizohet rritja më e madhe ekonomike.

Një tjetër komponentë stimuluese e BPV-së janë investimet e huaja direkte. Në gjatëmujorin e parë të këtij viti, Kosova pranoi mbi 164.7 milionë euro investime të huaja direkte (IHD) apo rreth 54 milionë më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.²⁹ Kjo rritje kryesisht ishte për shkak të tremujorit të parë i cili kishte një rritje prej 50 përqind. Këto investime ishin kryesisht në miniera, energji dhe patundshmëri.³⁰ Kjo ngritje paraqet një tjetër element stimulues që pamundësoi zvogëlimin e BPV-së në tremujorin e parë të këtij viti përkundër mbylljes së ekonomisë për më shumë se gjysmë muaji gjatë periudhës janar-mars.

Figura 8. Remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte në tremujorët e parë dhe dytë 2017-2020 (në miliona euro)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

26 Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Studimi mbi remitencat në Kosovë. Burimi: <https://bit.ly/2zFTOc7>

27 Banka Qendrore e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3eYO11t>

28 Ibid.

29 Banka Qendrore e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/2VM21Ek>

30 Ibid.


5. Ndryshimet në import dhe eksport të mallrave dhe shërbimeve

5.1 Importi dhe eksporti i mallrave

Deficiti tregtar i mallrave është komponent negativ i cili vazhdimisht rëndon rritjen e Bruto Produktit Vendor. Në gjatëmujorin e parë të këtij viti, rreth 146.2 milionë euro ose nëntë përqind më pak u importuan krahasuar me gjatëmujorin e parë të vitit 2019. Kjo rënie kryesisht ndërlidhet me zvogëlimin e konsumit të brendshëm në tremujorin e dytë. Në anën tjetër, eksportet u rritën për 31.8 milionë euro (20 përqind), me ç'rast deficiti tregtar u zvogëlua për rreth 178 milionë euro (-12 përqind).³¹

Gjatë gjashtëmujorit të parë, rënia më e madhe në import ishte te produktet që konsiderohen joesenciale si automjetet, artikujt e veshjes dhe mbathjes, pajisjet shtëpiake, materialet ndërtimore e të tjera të paraqitura në figurën 9.

Figura 9. Produktet me më së shumti rënie në import




Burimi: Dogana e Kosovës

Në anën tjetër, produktet me rritjen më të madhe në import krahasuar me gjatëmujorin e vitit të kaluar ishin produktet esenciale si vaji, sheqeri, drithërat, përgaditjet ushqimore, frutat, produktet farmaceutike, preparatet larëse dhe dezinfektuese, e të tjerë. Këto konsiderohen produkte bazike që nuk ndikohen shumë nga lëkundjet ekonomike. Në këtë ndryshim të sjelljes së konsumit mund të ketë ndikuar edhe vendimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve që në muajin mars liroi përkohësisht pagesën e TVSH-së për importet e grurit dhe miellit,³² dhe qeveria e cila mori vendim për heqjen e tarifës 100 përqind për produktet nga Serbia dhe Bosnia e Hercegovina.³³

³¹ Dogana e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/36hMfEz>

³² Republika e Kosovës. Vendimi. Burimi: <https://bit.ly/3bLeDjO>

³³ Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimet. Burimi: <https://bit.ly/3g3RegK>

Figura 10. Produktet me më së shumti rritje në import

Burimi: Dogana e Kosovës

Ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve i shpërfaqur në produkte të importuara mund të jetë i njëjtë edhe në prodhimet vendore, ku konsumi shtëpiak mund të orientohet kryesisht te produktet bazike dhe kësajsoj të shmangen shpenzimet joesenciale të cilat janë bazë e rritjes ekonomike.

Në anën tjetër, shpërfaqja e pandemisë në mënyrë të pashmangshme do të paraqesë pengesa në furnizim, sepse jo të gjitha shtetet do të hapen në të njëjtën kohë. Në këto rrethana, bizneset prodhuese vendore që janë në konkurrencë me importet, do të kenë një mundësi të veçantë të plasojnë më shumë produkte të tyre në treg. Krahas rritjes së eksportit, shpenzimi i parasë në produkte vendore është një ndër mënyrat më të mira për ta rritur qarkullimin e parasë dhe BPV-së brenda periudhës së recesionit ekonomik.

5.2 Bilanci i pagesave të shërbimeve

Në vitet e fundit Kosova vazhdimisht ka regjistruar bilanc pozitiv sa i përket pagesave të shërbimeve me vendet e tjera. Gjatë muajve janar-qershor të vitit 2020, shërbimet kishin një rënie prej 152.6 milionë euro apo rreth 52 përqind krahasuar me muajt e njëjtë të vitit paraprak. Mirëpo, përkundër kësaj, bilanci i shërbimeve vazhdoi të mbetet pozitiv për 5 milionë euro.³⁴ Ndikimin më të madh në rënie e të hyrave nga shërbimet e kishin të hyrat e udhëtimit të cilat ishin rreth 154 milionë euro më pak.³⁵ Në anën tjetër ngritje shënuan të hyrat nga shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit me rreth 168 përqind.³⁶


³⁴ Banka Qendrore e Kosovës. Shërbimet. Burimi: <https://bit.ly/36kThIU>

³⁵ Ibid.

³⁶ Ibid.

Kufizimet e udhëtimit gjatë tremujorit të dytë ndikuan më së shumti në rënie e të hyrave nga transporti. Mosardhja e diasporës do të ndikojë negativisht në të hyrat e shërbimeve edhe në muajt në vijim. Në anën tjetër, sektori i shërbimeve kompjuterike dhe teknologjike, që vazhdimisht ka shënuar bilanc pozitiv, pritet të ketë ngritje të të hyrave për shkak të nevojës së ekonomisë globale për t'i digjitalizuar disa shërbime në mënyrë që të funksionojë edhe gjatë pandemisë.

Figura 11. Bilanci neto i pagesave të shërbimeve




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

6. Ndryshimet e çmimeve

Pas vendosjes së masave emergjente, kishte një ngritje të papritur të kërkesës për produkte ushqimore dhe shërbime ambulatore e medicinale. Për këtë arsye, në tremujorin e parë çmimet e këtyre produkteve u ngritën. Në muajin mars, ministri i Financave dhe Transfereve dhe drejtori i ATK-së kërkuan zbatimin e masave kundër rritjes arbitrare të çmimeve gjatë periudhës së pandemisë.³⁷

Në tremujorin e dytë, me rënie të përgjithshme të kërkesës agregate, çmimet e ushqimit, veturave dhe të transportit shënuan rënie. Si rezultat, në tremujorin e dytë kishte një deflacion prej 1.2 përqind.³⁸

Figura 12. Ndryshimet e çmimeve të brendshme sipas tremujorëve 2018-2020



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës


³⁷ Ministri Besnik Bislimi kërkon nga ATK masa rigorozë ndaj bizneseve të cilat manipulojnë me çmimet në treg
Burimi: <https://bit.ly/2HmeV6Q>

³⁸ Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Mars 2020.
Burimi: <https://bit.ly/2YeXDyY>

Çmimet e brendshme të konsumit mund të pësojnë ndryshime edhe për shkak të lëkundjeve të çmimeve të importit, të cilat në tremujorin e parë ishin -0.6 përqind ndërsa në tremujorin e dytë -3.5 përqind.³⁹

Përgjatë gjashtëmujorit të parë, valutat ndërkombëtare pësuan lëvizje të mëdha. Kjo ndikoi në forcimin e euros karshi valutave tjera me të cilat Kosova bën tregti si: lira e Turqisë, leku i Shqipërisë, dinari i Serbisë e të tjera.⁴⁰ Forcimi i euros mundëson import më të lirë, kurse eksport më të shtrenjtë me vendet që nuk kanë valutën euro. Prandaj, pa konsideruar faktorët e tjerë, forcimi i euros dhe rënia e çmimeve të karburantit kanë zvogëluar çmimet e importit me disa vende të cilat nuk kanë valutën euro.

Figura 13. Ndryshimet e çmimeve të importit dhe prodhimit të brendshëm sipas tremujorëve



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës

7. Ndryshimet në buxhetin e shtetit

7.1 Ndryshimet në të hyrat buxhetore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020

Gjendja emergjente shëndetësore kishte efekte të mëdha edhe në të hyra dhe shpenzime buxhetore. Të hyrat e buxhetit në gjashtëmujorin e parë ishin rreth 760 milionë euro apo rreth 11 përqind më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndikimin më të madh në rënie e të hyrave patën TVSH në kufi me -30.6 milionë euro (-11 përqind), tatimi në të ardhura të korporatave (-15 përqind), tatimet tjera direkte (-76 përqind), detyrimet doganore (-23 përqind) e të tjera të paraqitura në figurën 14. Trendet e rënies së të hyrave buxhetore janë regjistruar

39 Indeksi i Çmimeve të Importit, TM1 2020. Burimi: <https://bit.ly/3eOYKen>

40 XE. Burimi: <https://bit.ly/2EC36Zm>

kryesisht në tremujorin e dytë dhe ndërlidhen me rënien e konsumit të shpërfaqur në TVSH dhe performancën e dobët të sektorit privat të shkaktuar nga situata e pandemisë. Në anën tjetër pati rritje të të hyrave buxhetore nga pranimet e tjera si huazimet e jashtme dhe të brendshme të cilat u rritën për rreth 100 milionë euro ose 164 përqind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar.

Tabela 3. Të hyrat buxhetore në gjashtëmujorët e parë të viteve 2019-2020

Përshkrimi			Ndryshimi	
	2019 në miliona €	2020 në miliona €	në miliona € (2020-2019)	Ndryshimi në % (2020/2019)
1. Gjithsej Pranimet	1,075.61	989.67	-85.94	-8%▼
1.1 Të hyrat buxhetore	853.51	760.35	-93.16	-11%▼
1.1.1 Të hyrat tatimore	755.12	683.93	-71.19	-9%▼
1.1.1.1. Tatimet Direkte	146.76	126.1	-20.66	-14%▼
Tatimet në të ardhurat e korporatave	49.22	41.9	-7.32	-15%▼
Tatimet në të ardhurat personale	82.16	74.76	-7.40	-9%▼
Tatimi në pronë	13	8.86	-4.14	-32%▼
Tatime tjera direkte	2.38	0.58	-1.80	-76%▼
1.1.1.2. Tatimet Indirekte	628.89	569.13	-59.76	-10%▼
Tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH	375.89	339.2	-36.69	-10%▼
Detyrimi Doganor	58.66	45.31	-13.35	-23%▼
Akcizat	192.7	183.68	-9.02	-5%▼
Tatimet tjera indirekte	1.64	0.94	-0.70	-43%▼
1.1.1.3. Kthimet tatimore	-20.54	-11.3	9.24	-45%▼
1.2. Të hyrat jo-tatimore	98.39	76.42	-21.97	-22%▼
1.2. Pranimet nga financimi	222.1	229.33	7.23	3%▲
Huamarrja e jashtme	19.96	72.79	52.83	265%▲
Huamarrja e brendshme	45.33	92.57	47.24	104%▲
Fondet e likuidimit të AKP-së	150	55.05	-94.95	-63%▼
Të tjera	6.81	8.92	2.11	31%▲

Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve⁴¹

7.2 Ndryshimet në shpenzime buxhetore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, shpenzimet buxhetore u rritën për rreth 18.8 milionë euro apo 2.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në nivel qendror, reduktime të shpenzimeve kishte në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për 4.2 milionë (-6 përqind), shpenzime komunale për afër 1 milionë euro (-13 përqind) dhe shpenzime kapitale për rreth 40 milionë (-40 përqind). Në të njëjtën kohë u rritën shpenzimet e pagave për mbi 17 milionë (10 përqind), transferet sociale për 18 milionë (7 përqind) dhe subvencionet për 39 milionë (82 përqind) krahasuar me gjashtëmujorin e vitit të kaluar.

41 Ministria e Financave dhe Transfereve. Raport Gjashtëmujor Financiar. Burimi: <https://bit.ly/3i83oGM>


Figura 14. Shpenzimet buxhetore qendrore në gjashtëmujorët e parë të viteve 2019-2020



Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve

Ndyshime të shpenzimeve pati edhe në nivel lokal. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, këtë vit kishte rënie të shpenzimeve kapitale për 8.2 milionë (-20 përqind), subvencione dhe transfere për 7.8 milionë (-70 përqind) ndërkohë kishte ngritje të shpenzimeve në paga për 4.4 milionë (3 përqind), mallra dhe shërbime (2.5 milionë).

Figura 15. Shpenzimet buxhetore komunale në gjashtëmujorët e parë të viteve 2019-2020



Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve

Deficiti buxhetor në gjashtëmujorin e parë të këtij viti ishte rreth 117 milionë euro. Ky deficit ka të bëjë më shumë me rënien e të hyrave se sa me rritje të shpenzimeve buxhetore. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, këtë vit shpenzimet u rritën për vetëm 18.8 milionë euro ose rreth 2 përqind. Ndërkohë, për të adresuar situatën emergjente kishte riorientim të shpenzimeve brenda hapësirave ligjore si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Në të dy nivelet në gjashtëmujorin e parë shpenzimet kapitale u reduktuan.

Pa konsideruar faktorët e tjerë, riorientimi i shpenzimeve nga një kategori në tjetrën mund të ndikojë në uljen e pabarazisë në shoqëri të shkaktuar nga pandemia, mirëpo jo domosdoshmërisht në rritjen e Bruto Produktit Vendor në afat të shkurtër. Për të lehtësuar rënien e aktivitetit ekonomik apo BPV-së, kërkohet rritja e shpenzimeve publike në përgjithësi për të mbuluar mosshpenzimin e sektorit privat. Për këtë arsye, deri në muajin qershor, qeveria ka marrë vendim për emitimin e letrave me vlerë për 92.57 milionë euro dhe ka nënshkruar disa marrëveshje ndërkombëtare për financim me vlerë prej 68.95 milionë euro të cilat rritën kapacitetin shpenzues.⁴²

7.3 Masat stabilizuese të ekonomisë nga Qeveria e Kosovës

Gjatë recesioneve ekonomike, kapaciteti njerëzor dhe prodhues mbetet i njëjtë sikur në rrethana normale, mirëpo mungon funksionalizimi i plotë i tij. Qytetarët dhe bizneset të përballur me pritje të ulëta për të ardhmen ekonomike, reduktojnë shpenzimet. Marrë parasysh se shpenzimi i një individi është e ardhur për dikë tjetër, ulja e kërkesës së përgjithshme medoemos ul të ardhurat e të gjithë qytetarëve e rrjedhimisht edhe BPV-në. Në këto rrethana kur qytetarët nuk shpenzojnë, buxheti i shtetit është i vetmi burim me peshë që mund ta rikthejë qarkullimin e parasë dhe funksionalizojë kapacitetin prodhues.

Për fat të mirë, Kosova jo vetëm që ka një borxh publik relativisht të ulët me rreth 20 pikë përqindje larg kufirit ligjor, por edhe një ambient likuid bankar, ku sektori publik dhe ai privat nuk konkurrojnë për kredi. Rritja e shpenzimeve dhe mbajtja e tatimeve të ulëta, rrit deficitin buxhetor dhe borxhin publik në afat të shkurtër. Mirëpo, në anën tjetër kursehen paratë që në të kundërtën do të shpenzoheshin në skema të ndryshme të asistencës sociale apo reduktim të të hyrave tatimore si pasojë e ekonomisë së zvogëluar.

Pas mbylljes së aktivitetit ekonomik, Ministria e Financave dhe Transfereve, më 30 mars 2020, mori aprovimin e qeverisë për “Pakon Fiskale Emergjente” me vlerë prej 190 milionë euro për të reduktuar dëmin e ndaljes së të hyrave nga mbyllja e një pjese të madhe të ekonomisë.⁴³ Kjo pako përbëhet prej 15 masave. Pjesa e parë që përfshin masat 1, 2, 9, 15 është dizajnuar me qëllim që t’u ofrojë mbështetje grupeve të shoqërisë të cilët janë më të ekspozuar ndaj varfërisë ekstreme, siç janë përfituesit e ndihmave sociale, grupet joshumicë, personat me punësim të paqëndrueshëm dhe ata të sektorit joformal të ekonomisë. Pjesa e dytë adreson të punësuarit përmes masave 3, 7 dhe 14 me shtesa prej 170 euro si dhe stimuj bizneseve për regjistrimin e punëtorëve në sektorin formal. Pjesa e tretë i përket bizneseve ku Qeveria e Kosovës merr përsipër pagesën e deri në 50 përqind të qirasë së bizneseve të prekur nga gjendja emergjente. Po ashtu, në këtë pjesë ofrohet edhe garantimi i kredisë për 30 përqind mbi atë të

⁴² Ministria e Financave dhe Transfereve. Të dhënat tremujore mbi borxhin e përgjithshëm.

Burimi: <https://bit.ly/3kUNYGs>

⁴³ Ministria e Financave dhe Transfereve të Kosovës. Vendimi Nr.31/2020. Burimi: <https://bit.ly/2Sw4cKb>

Fondit Kosovar për Garanci Kreditore për të lehtësuar kreditimin, shtyhen datat e deklarimit të obligimeve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës dhe ofrohet ndihmë ndërmarrjeve publike dhe atyre private që ofrojnë të njëjtat produkte ose shërbime si ato publike. Përshkrimin e plotë të pakos mund ta gjeni në aneks.

Mundësia e fundit për të aplikuar për masat e “Pakos Emergjente” ishte 15 maj 2020. Në tremujorin e dytë, mbi 100 mijë përfitues të skemave sociale morën pagesë të dyfishtë për tre muaj (Masa 1) dhe 116.770 morën shtesa prej 30 euro (Masa 2).⁴⁴ Brenda kësaj periudhe, 116.770 punëmarrës përfituan pagesën e 170 eurove (Masa 3) kurse 44 mijë të tjerë ishin në pritje të kësaj pagese. Përfituesit e masave të tjera janë paraqitur në aneks.

Pakoja emergjente nuk u implementua në tërësi në tremujorin e dytë dhe si rezultat shumë persona që plotësuan kushtet për të përfituar nga kjo pako nuk morën mbështetjen në kohën e duhur. Vonesat në implementimin e pakos, ndër tjerash, u shkaktuan edhe për shkak të prishjes së koalicionit qeverisës dhe ndërrimit të qeverisë.

Ende pa përfunduar implementimi i plotë i pakos së parë, në tremujorin e dytë u hartua pako e dytë “Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike” e cila mban shumën e mbi një miliardë eurove dhe kërkon aprovim të Kuvendit. Marrë parasysh shkarkimin e qeverisë dhe vonesat në formimin e qeverisë së re, është ende e paqartë kur do të kalojë pako e dytë. Mungesa ose vonesa e ekzekutimit të shpejtë të “Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike” në fillim të tremujorit të tretë mund të shkaktojë pasoja të pariparushme ekonomike e sociale në vend. Shumë familje dhe ndërmarrje ekonomike në mungesë të të hyrave karshi obligimeve financiare si kredi apo borxhe të tjera do të detyrohen të shesin asetete të ndryshme. Kjo do të ishte normale në raste të izoluar, mirëpo nëse shumica e ndërmarrjeve ose familjeve marrin vendime të tilla atëherë rrezikon të shkaktohet rënie e çmimeve të përgjithshme me ç’rast zhvlerësohen të gjitha asetet ekzistuese duke përkeqësuar edhe më tutje gjendjen.

44 Ministria e Financave dhe Transfereve. Pakoja e Rimekembjes Ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/2HweN4T>

8. Përfundime

Pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19, më 13 mars 2020 Qeveria e Kosovës mori vendim për mbylljen e të gjitha aktiviteteve ekonomike me përjashtim të disa veprimtarive esenciale si furnizimi me produkte ushqimore dhe medicinale. Edhe pse shumica e tremujorit të parë vazhdoi në mënyrë normale, mbyllja sociale për pak ditë shkaktoi efekte të menjëhershme në ekonomi. Bruto Produkti Vendor në tremujorin e parë pati rritjen më të ulët në katër vitet e fundit ndërsa në tremujorin e dytë u zvogëlua për 9.28 përqind.

Situata emergjente ndikoi në ndyshimin e sjelljes së konsumatorëve ku ekonomitë familjare ngritën shpenzimet për produkte bazike si ushqimi, uji dhe energjia elektrike ndërsa reduktuan shpenzimet joesenciale. Kjo shpërfaqet në të dhënat e importit dhe performancën e industrive në Kosovë. Aktivitetet ekonomike të cilat shënuan rritje në tremujorin e dytë ishin industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, dhe furnizimi me ujë me 19.8 përqind dhe informacioni dhe komunikimi me 29.6 përqind. Ndërkohë rënie të të hyrave patën të gjitha industritë e tjera. Rënia më e lartë u shënuar në industrinë e ndërtimit me -47.08 përqind, dhe tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor me -24.4 përqind.

Pas masave kufizuese, Banka Qendrore në bashkëpunim me institucionet kredihënëse ofruan mundësinë e shtyrjes së pagesave të kësteve të kredisë për tre muaj, e më pas mundësinë e aplikimit për ristrukturimin e tyre. Në të njëjtën kohë të dhënat e sistemit bankar pasqyruan sinjalet e rënies së kërkesës agregate ku depozitat bankare u rritën ndërsa kreditë e reja pësuan rënie.

Qeveria e Kosovës në përpjekje për të stimuluar konsumin e brendshëm dhe lehtësuar gjendjen ekonomike, aprovoi pakon e parë fiskale me vlerë prej 190 milionë euro. Po ashtu propozoi riorientimin e shpenzimeve buxhetore brenda kufizimeve ligjore, nga kategoria e shpenzimeve kapitale në kategorinë e pagave, transfereve dhe subvencioneve. Megjithëse një numër i madh i qytetarëve dhe bizneseve përfituan nga kjo pako, implementimi i plotë i saj nuk ndodhi në tremujorin e dytë. Si rezultat në gjashtëmujorin e parë shpenzimet ishin vetëm 18.8 milionë euro ose rreth 2 përqind më të larta se në gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak. Riorientimi i buxhetit si masë e vetme pa rritur borxhin publik do të jetë i padobishëm në mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike.

Kosova ka një borxh publik mjaft të ulët dhe një sistem financiar tejet likuid dhe mirë të kapitalizuar. Kjo ofron mundësi institucioneve publike që të intervenojnë në ekonomi për të ngadalësuar rëniën e prodhimit të brendshëm. Tremujori i dytë e veçanërisht tremujori i tretë është koha kur Kosova realizon prodhimin më të lartë në vit. Kjo periudhë do të jetë thelbësore në pasqyrimin e dëmit ekonomik që po shkakton pandemia. Rrjedhimisht do të shpërfaqë kapacitetin e institucioneve mbështetëse ekonomike si ato financiare dhe publike se sa janë të aftë t'i shfrytëzojnë përparësitë e lartëcekura për ta menaxhuar situatën ekonomike.

9. Aneksi

Aneks 1. Përmbledhje e masave të dala nga Pako Fiskale Emergjente

Përshkrimi i masave	Nr. i përfituesve	Shuma maksimale (€)
1. Pagesë e dyfishtë e vlerës së skemës sociale (prill-qershor).	100.564	7.65 milionë
2. Pagesa shtesë prej 30€ për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale me pagesë nën 100€ (prill-qershor) me kusht që të jenë përfitues të vetëm një skeme, përfshirë ata që kanë qenë në skemë nga janari i këtij viti, por nuk kanë riaplikuar.	167.768	13 milionë
3.1 Mbulimi i pagave mujore të punonjësve prej 170€ për periudhën prill-maj për shoqëritë tregtare në vështirësi nga gjendja emergjente.	116.770	41 milionë
3.2 Subvencioni i qirasë deri në 50 përqind për muajin prill-maj për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që janë në vështirësi.	14, 988	12 milionë
3.3 Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin prill-maj.	N/A	8 milionë
4. Huadhënje pa interes për ndërmarrjet publike me vështirësi financiare për ta ruajtur likuiditetin me kthim deri me 31.12.2020.	N/A	20 milionë
5. Mbështetje financiare komunave të Kosovës të ndikuara nga pandemia në rast të nevojës.	N/A	10 milionë
6. Shtesa mbi pagë në vlerë prej 300€ për punëtorët në terren dhe ata të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre si: stafi mjekësor, policët, gardianët e Shërbimit Korrektues, zjarrëfikësit, personeli FSK-së, punëtorët që punojnë në Karantinë-Qendra e Studentëve të Prishtinës, inspektorët e të tjerë për muajin prill-maj.	22.088	15 milionë
7. Pagesë shtesë prej 100€ për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave, dhe barnatoreve për muajin prill-maj.	10.685	3 milionë
8. Pagesa e asistencës mujore prej 130€ për qytetarët që humbin vendin e punës për shkak të situatës emergjente për muajin prill-maj.	5.559 amvisëri	4 milionë
9. Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë që janë goditur rëndë nga pandemia.	N/A	2 milionë
10. Sigurimi i likuiditetit për:	N/A	15 milionë
1. Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore deri në 10 mijë euro me maturitet prej 24 muaj. Pra, 50 përqind nga FKGK dhe deri në 30 përqind nga kjo masë.		
2. Shoqëritë tregtare/kompanitë të autorizuara që ofrojnë shërbime bazike të ngjajshme me ndërmarrjet publike me kthim deri në 31.12.2020.		
11. Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor.	N/A	5 milionë
12. Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit për evitim të situatës së krijuar.	N/A	5 milionë
13. Mbështetje për eksportuesit e Kosovës pas përfundimit të situatës emergjente.	N/A	10 milionë
14. Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një vit gjatë situatës emergjente me nga 130€ për dy muajt pasues pas regjistrimit.	N/A	6 milionë
15. Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130€ për qytetarët me kushte të rënda sociale që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës për muajin prill-qershor. Këtu përfshihen punëtorët sporadik që nuk kanë një punë stabile.	N/A	3 milionë

Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve⁴⁵

Aneks 2. Të hyrat dhe kthimet nga Dogana e Kosovës për periudhën janar-qershor 2020

Llojet e të hyrave	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020/2019)	Krahasim % (2020/2019)
në miliona Euro					
Të hyrat bruto	504.36	526.25	471.43	-54.83	-10%
TVSH	263.02	271.07	240.47	-30.61	-11%
Tarifa doganore në import	55.07	58.66	45.31	-13.36	-23%
Akciza në kufi	176.9	188.03	183.6	-4.43	-2%
Akciza e brendshme	7.26	4.67	0.09	-4.59	-98%
Tjera /1	2.11	3.82	1.97	-1.85	-48%
Kthimet	-3.79	-0.63	-0.65	-0.01	2%
Kthimi i TVSH	-0.26	-0.25	-0.41	-0.16	66%
Kthimet tjera /2	-3.53	-0.39	-0.24	0.15	-39%
Të hyrat net	500.57	526.62	470.78	-54.84	-10%

Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve

Instituti GAP është një think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë

Tel: +383 38 609 339


info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World





Ndikimi i pandemisë COVID-19
në ekonominë e Kosovës
Analizë për periudhën
janar-qershor